

BPrAL kolegji-heimerer



PrBHE college-heimerer



Nr. Prot: 617/22 Data: 24/05/2022
Prot. No: 617/22 Date: 24/05/2022

Njësia: 1 Prishtinë

kolegji-heimerer 
Arsim dhe Karrierë në Shëndetësi

BPrAL "KOLEGJI HEIMERER"

RREGULLORE MBI ETIKËN E PUNËS NË HULUMTIME DHE FUSHËVEPRIMIN E KOMITETIT TË ETIKËS NË HULUMTIME

Prishtinë

Maj 2022

Në bazë të Statutit të BPrAL Kolegji-Heimerer, sipas propozimit të Këshillit Akademik të datës 18.05.2022, Rektori/ja e BPrAL Kolegji-Heimerer, me datë 24.05.2022 miratoi këtë Rregullore:

**MBI ETIKËN E PUNËS NË HULUMTIME DHE FUSHËVEPRIMIN E KOMITETIT TË ETIKËS
NË HULUMTIME**

Të gjitha nenet e kësaj rregullore janë hartuar duke u bazuar në parimet e Deklaratës të Helsinkit dhe në përputhje me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të Republikës së Kosovës.

1. Qëllimi

- 1.1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e praktikave dhe vlerësimit të etikës hulumtuese në studimet e kryera në kuadër të Kolegjit Heimerer.
- 1.2. Kjo rregullore zbatohet gjatë gjithë punës hulumtuese nga i gjithë stafi i Kolegjit Heimerer dhe studentët e regjistruar që realizojnë ose planifikojnë të realizojnë hulumtime.

2. Komiteti i Etikës në Hulumtime

- 2.1. Komiteti i Etikës në Hulumtime themelohet me vendim të Këshillit Akademik të Kolegjit Heimerer.
- 2.2. Komiteti i Etikës në Hulumtime përbëhet nga të paktën pesë anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Akademik i Kolegjit Heimerer sipas propozimit të Prorektorit për Hulumtim. Mandati i anëtarëve është përhershëm.
- 2.3. Anëtarët e Komitetit të Etikës në Hulumtime duhet të jenë: përfaqësues të lartë të departamenteve në Kolegjin Heimerer, dhe të kenë profil të ndërlidhur me hulumtimet shkencore, që mund të përfshijë veprimtarinë e tyre autoriale në këtë fushë, ose rol me përgjegjësi të ndërlidhur me hulumtime shkencore.
- 2.4. Kryetari i Komitetit zgjedhet nga mesi i anëtarëve të Komitetit.

3. Mbledhjet dhe Vendimmarrja në Komitetin e Etikës në Hulumtime

- 3.1. Vendimet në Komitet merren me shumicë votash.

- 3.2. Mbledhjet e Komitetit Etik do të thirren nga Kryetari i Komitetit të Etikës për Hulumtime. Qëllimi i mbledhjeve është vendosja mbi kërkesat për lejim të hulumtimeve shkencore biomjekësore dhe sociale që paraqiten nga palët e interesuara.
- 3.3. Pas vendimeve dhe rekomandimeve të nxjerra në mbledhje, hulumtuesit njoftohen për statusin e aplikimeve të tyre përmes Përfaqësuesit të Prorektoratit për Hulumtime.

4. Afatet e punës / marrja e vendimeve

- 4.1. Kriteret objektive për dhënie të lejes për hulumtime do të përcaktohen në Shtojcën A të kësaj Rregullore, që mbështetet në dispozitat e Deklaratës së Helsinkit, si dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të Republikës së Kosovës. Në rast të konfliktit, Komiteti e merr një vendim final në bazë të shumicës së thjeshtë.
- 4.2. Përtej Shtojcës A, dispozitave të Deklaratës së Helsinkit, si dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të Republikës së Kosovës, Komiteti gjithashtu mbështetet në rregulloret e tjera të brendshme të institucionit për çështje që ndërlidhen me përmbajtjen e hulumtimit, duke përfshirë këtu vendimin/udhëzimin për plagjiaturë, dhe dispozita tjera të ndërlidhura direkt me hulumtimin, nëse ka.
- 4.3. Komiteti i Etikës në Hulumtime duhet të bëjë vlerësimin e një kërkesë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë pune. Ky afat mund të shtyhet kur për shkak të kompleksitetit të kërkesës nevojitet më shumë kohë. Në të gjitha rastet, për këtë informohet paraprakisht hulumtuesi.
- 4.4. Vonesa nga paragrafi 4.1 i këtij neni mund të ndodhin edhe në rastet kur formulari i aplikimit nuk është plotësuar tërësisht; nëse Komiteti kërkon më shumë informacion, ose nëse një aplikim vlerësohet si i diskutueshëm nga anëtarët.
- 4.5. Hulumtuesit/et duhet ta bëjnë adresimin e komenteve, nëse ka, në afat kohor prej dhjetë ditë pune pas pranimit të kërkesës për plotësim nga Komiteti i Etikës në Hulumtime. Komiteti duhet të shikojë versionin e rishikuar të dokumenteve dhe më pas të marrë vendimin përkatës. Në rast të vonesës së paarsyetuar në plotësim të kërkesës, do të konsiderohet se Hulumtuesi/ja ka tërhequr kërkesën e paraqitur.

5. Kompetencat e Komitetit të Etikës në Hulumtime

5.1. Komiteti i Etikës në Hulumtime ushtron kompetencat në vijim:

5.1.1. Aprovimi i aplikimeve për miratim etik;

- 5.1.2. Pranimi i ankesave për vendimet e mëparshme, të rregulluara më tutje në nenin 11.3;
- 5.1.3. Pranimi i ankesave për shkelje etike nga palë të caktuara brenda institucionit;
- 5.1.4. Anulimi i miratimit të dhënë paraprakisht në rast të shkeljeve të parimeve apo informatave të dorëzuara në aplikimin fillestar.

6. Zbatimi i etikës në hulumtime

- 6.1. Parimi kryesor i të gjitha hulumtimeve në Kolegjit Heimerer është respektimi i dinjitetit, të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së pjesëmarrësve.
- 6.2. Çështjet që i nënshtrohen procedurave të etikës në hulumtime janë:
 - 6.2.1. Temat e diplomës së studentëve të Kolegjit Heimerer;
 - 6.2.2. Hulumtimet e stafit akademik nën afilacionin e Kolegjit Heimerer;
 - 6.2.3. Projektet hulumtuese në të cilat stafi i Kolegjit Heimerer mban afilacionin e institucionit;
 - 6.2.4. Mbledhja e të dhënave në hapësirat e Kolegjit Heimerer.
 - 6.2.5. Projektet hulumtuese të zbatuara nga individë të jashtëm, në të cilat stafi i Kolegjit Heimerer është i përfshirë në ndonjë rol bashkëpunues përgjatë ciklit të projektit. Për projekte hulumtuese të jashtme, Komiteti Etik ka të drejtën të rekomandojë forma të vendimmarrjes për miratim nga institucioni i Kolegjit Heimerer, duke përfshirë këtu vendosjen e një kosto për aplikim.
- 6.3. Dokumentet nga ky nen duhet të vlerësohen për rrezikshmëri etike dhe aty ku aplikohet, të rishikohen dhe të merret miratimi i Komitetit të Etikës në Hulumtime, përpara se të fillojë mbledhja e të dhënave.
- 6.4. Kjo qasje zbatohet për të gjithë stafin e Kolegjit dhe studentët e regjistruar që realizojnë ose kontribuojnë në aktivitete shkencore. Këtu përfshihen gjithashtu projekte bashkëpunuese që përfshijnë një ose më shumë bashkëpunëtorë nga institucione të tjera. Në rastin si ky i fundit, hulumtuesit duhet të sigurohen që gjatë hartimit të projektit e përcaktojnë qartë mënyrën dhe ku do të kërkohet miratimi etik për hulumtimin.
- 6.5. Hulumtuesit e kanë për detyrë të kujdesen për të gjithë individët të cilët mund të ndikohen në çfarëdo mënyre nga procesi i hulumtimit, jo vetëm ndaj atyre që janë të përfshirë drejtpërdrejt si pjesëmarrës; potenciali për dëmtim ose shqetësim për çdo individ të tillë duhet të merret parasysh në planifikim të studimit dhe të ndërmerren hapat e duhur për ta adresuar këtë rrezik aty ku është e nevojshme.

7. Detyrimet e hulumtuesve

- 7.1. Hulumtuesit gjatë hulumtimeve të tyre i nënshtrohen kritereve hulumtuese të përcaktuara nga Komiteti apo hulumtuesi në lidhje me hulumtimin.
- 7.2. Gjatë punës së tyre, hulumtuesit kujdesen në vazhdimësi që hulumtimi të kryhet me ndershmëri, integritet, rrezik minimal të mundshëm për pjesëmarrësit dhe për vetën e tyre, si dhe respekt të vazhdueshëm për njerëzit, vlerat dhe kulturën e tyre.
- 7.3. Detyrimet e hulumtuesve janë më tutje të përcaktuara në dispozitat e Deklaratës së Helsinkit, e cila i bashkëngjitet kësaj rregullore në gjuhën shqipe.

8. Të drejtat e pjesëmarrësit në hulumtime

8.1. Në bazë të nevojave të hulumtimit, pjesëmarrësit gëzojnë të drejtat në vijim:

- 8.1.1. të jenë plotësisht të informuar se si dhe pse të dhënat e tyre do të mbliidhen dhe përdoren si pjesë e një projekti hulumtues dhe nga kush;
 - 8.1.2. konfidencialiteti: informacioni personal ose të dhënat e identifikueshme nuk duhet të zbulohen pa pëlqimin e pjesëmarrësve dhe do të përdorën vetëm për qëllime për të cilat pjesëmarrësi është pajtuar më herët;
 - 8.1.3. sigurinë e të dhënave të tyre: të dhënat dhe mostrat e mbledhura duhet të mbahen të sigurt dhe të anonimizuara aty ku është e përshtatshme;
 - 8.1.4. sigurinë: pjesëmarrësit nuk duhet të ekspozohen ndaj niveleve të pa nevojshme ose jo proporcionale të rrezikut, dhe;
 - 8.1.5. të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre nëse dhe kur ato nuk kërkohen më për qëllime kërkimore.
- 8.2. Gjatë gjithë hulumtimit, hulumtuesit do të kujdesen që të dhënat personale të pjesëmarrësve të trajtohen dhe përpunohen sipas legjislacionit mbi të dhënat personale.
 - 8.3. Të drejtat e tjera janë të përcaktuara në dispozitat e Deklaratës së Helsinkit, si dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore të Republikës së Kosovës.

9. Procedura e aplikimit

- 9.1. Të gjithë personat që i përkasin ndonjëres prej kategorive të përshkruara në nenin 6.2., duhet të përcjellin procedurën e mëposhtme të aplikimit për miratim etik:

9.1.1. Hulumtuesi/ja plotëson dhe dorëzon dokumentacionin e plotë për propozimin përkatës.

Dokumentacioni duhet të përfshijë:

- a.) formularin për miratim etik,
- b.) formën e pëlqimit,
- c.) fletën informuese të studimit,
- d.) pyetësorët ose mjetet e tjera kërkimore që ata planifikojnë të përdorin, në formën e tyre finale para përdorimit.

9.1.2. Dokumentacioni i plotë për miratim etik dërgohet tek përfaqësuesi i Prorektoratit për Hulumtime, i/e cili/a i përcjellë ato tek anëtarët e Komitetit.

9.1.3. Anëtarët e Komitetit mund të kërkojnë të shqyrtojnë më pas edhe dokumente tjera të ndërlidhura me hulumtimin e propozuar.

10. Procedura e miratimit etik për studentë

10.1. Studentët të cilët janë duke realizuar temat e diplomës si projekti përfundimtar hulumtues akademik gjithashtu duhet të marrin miratim etik për projekt propozimet e tyre.

10.2. Kandidatët plotësojnë formularin për miratim etik për projekt propozimin e tyre, së bashku me miratimin e mbikëqyrësit/ mentorit/es së temës së diplomës.

10.2.1. Studentët dorëzojnë formularin të shoqëruar me dokumentacion përkatës, që përfshin:

- a.) formularin për miratimin etik,
- b.) formën e miratimit nga mentori,
- c.) fletën informuese të studimit,
- d.) fletën e pëlqimit për pjesëmarrës,
- e.) instrumentet ose mjete të tjera matëse që ata planifikojnë të përdorin, në formën e tyre përfundimtare.

10.2.2. Propozimet për të cilat kërkohet miratimi etik dërgohen tek përfaqësuesi i Prorektoratit për Hulumtime, i/e cili/a i përcjellë ato tek anëtarët e Komitetit.


10.2.3. Anëtarët e Komitetit të Etikës në Hulumtime kanë të drejtë të kërkojnë dokumente tjera shtesë të ndërlidhura me këtë hulumtim.

11. Vlerësimi i aplikimeve

- 11.1. Kryetari i Komitetit të Etikës në Hulumtime thërret takimin e Komitetit për Etikë në Hulumtime, ku merren vendimet për aplikimet për miratim në bazë të informacioneve të dorëzuara. Vendimet e Komitetit do të mbështeten në kriteret dhe parimet e Etikës të cilat i bashkëngjiten kësaj rregullore (Shtojca A), Ligjit për Kërkim dhe Veprimtari Shkencore të Republikës së Kosovës, si dhe Deklaratës së Helsinkit.
- 11.2. Duke marrë parasysh implikimet etike të projekteve, Komiteti i Etikës në Hulumtime mund të marrë vendime si në vijim:
- 11.2.1. Miratim: projekti mund të vazhdojë pa asnjë ndryshim.
- 11.2.2. Ndryshime të detyrueshme: projekti nuk mund të vazhdojë derisa të bëhen ndryshimet e kërkuara dhe të dorëzohen në riaplikim;
- 11.2.3. Refuzim (i pa miratuar): projekti nuk mund të vazhdojë, për arsye që duhet të specifikohen qartë në një përgjigje me shkrim, të mbështetura në këtë rregullore dhe parimet etike dhe dokumentet në të cilat bazohen.
- 11.3. Vendimet e Komitetit nuk mund të atakohen. Aplikuesit mund të kërkojnë të apelojnë vendimin, duke kërkuar themelimin e një Komisioni Ad-Hoc për vlerësim të apelit. Komisionet Ad-Hoc mund të themelohen vetëm në rast se institucioni, në këtë rast i përfaqësuar nga Rektorati i Kolegjit Heimerer, ka mundësinë të delegojë anëtarë të kualifikuar në këto komisione, të cilët nuk janë tashmë pjesë e Komitetit për Etikë në Hulumtime.
- 11.4. Komiteti për Etikë në Hulumtime njeh vendimet e marra paraprakisht për ndonjë projekt nga organet e tjera të mandatuara për miratim etik të hulumtimeve shkencore.

12. Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Rektorja.


Rektore e Kolegjit Heimerer
Prof. Ass. Dr. Naime Brajshori

